



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: 21. 03. 2025		
Prilajmë:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-12757		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ

(Java e Kulturës në Komunën e Lipjanit)

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi kriteret,standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

Drejtoriati për Kulturë,Rini dhe Sport bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, Rinisë të aplikojnë për mbështetje financiare për projektin **JAVA E KULTURËS NË KOMUNËN E LIPJANIT**.

Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një project përmë aktiviteteve si më poshtë:

Objektivat:

- Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjëve në kulturë
- Dokumentimi dhe promovimi i vlerave të luftës së UÇK-së
- Promovimi i kulturës muzikore tradicionale Kombëtare

Aktivitetet:

- Organizimi i ekspozites me fotografi të Dëshmorëve të UÇK-së
- Organizimi i Orës Letrare
- Shfaqje e filmit me temë Kombëtare
- Organizimi i koncertit festiv me muzikë dhe valle Tradicionale Kombëtare

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 4.000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo project është 501.00euro, ndërsa shuma maksimale për një project është 4.000.00 euro.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me 14.04.2025.

OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me një (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje,ndërsa periudha e zbatimit të projektit është 1 deri 30 ditë.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare* (*web faqen* www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr.1 dhe nr.2.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën (fadil.krasniqi@rks-gov.net)

Lipjan, më 21.03.2025


Anila Reçica Llugini
Drejtoreshë e DKRS-së